



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ 2023

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT, PROGRAMET DHE FINANCIMIN E SHËRBIMIT TË  
SPECIALIZUAR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84, pika 3 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozim të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Objekti i këtij vendimi është miratimi i rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programeve dhe financimin e institucioneve ose personave juridik të licencuar, për zbatimin e masës së sigurimit të vendosjes në shërbim të specializuar për të miturin në konflikt me ligjin.

**KREU II  
RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË SPECIALIZUAR**

**Neni 2  
Organizimi i shërbimeve të specializuara**

1. Institucioni ose personi juridik i licencuar i caktuar për zbatimin e masës së sigurimit për vendosjen e të miturit në konflikt me ligjin në një shërbim të specializuar (këtu e në vijim “*ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin*”) duhet të ketë një strukturë të përshtatshme të personelit në përputhje me nevojat e përfituesve të mitur.

2. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mund të jenë persona juridikë publikë ose jopublikë.

3. Në rastin e ofruesit publik, shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin realizohen nga organet përgjegjëse për ofrimin e kujdesit shoqëror për të miturit në Republikën e Shqipërisë në nivel vendor dhe në përputhje me ligjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjes e fëmijës.

4. Në rastin e ofruesit jopublik, shërbimet e specializuara, realizohen vetëm nga organe të licencuar edhe për këtë qëllim. Licencimi i ofruesve të shërbimeve të specializuara bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

5. Për ofrimin e shërbimeve të specializuara, ofruesit duhet të kenë kapacitetet e nevojshme për ngritjen e grupeve multidisiplinare për evidentimin e nevojave të të miturit dhe hartimin e planit individual të mbikëqyrjes.

6. Institucioni ose personi juridik i licencuar për zbatimin e masës së sigurimit për vendosjen e të miturit në konflikt me ligjin në një shërbim të specializuar harton rregulla të brendshme të organizimit dhe funksionimit të shërbimit. Këto rregulla duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar dhe të jenë të afishuara në mjediset ku ofrohet shërbimi i specializuar.

7. Këto rregulla janë pjesë e protokollit të standardeve të shërbimit, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

### Neni 3

#### **Shërbimi i specializuar**

1. Me qëllim ofrimin e shërbimit të specializuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, çdo 6 muaj përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale raportim mbi kapacitetet për ofrimin e shërbimeve të specializuara.

2. Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë kapacitete për ofrimin e shërbimeve të specializuara mund të kontraktojnë subjekte private për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, me anë të procedurave të prokurimit, në përputhje me ligjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale përditëson listën e institucioneve dhe subjekteve të licencuar për ofrimin e shërbimeve shoqërore të specializuara çdo 6 muaj. Lista e institucioneve dhe subjekteve të licencuar u vendoset në dispozicion gjykatave me qëllim vendosjen e masës së sigurimit.

### Neni 4

#### **Personeli për ofrimin e shërbimit të specializuar**

1. Për secilin pozicion pune, ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin harton përshkrimin e vendeve të punës ku përcaktohen përgjegjësitë, detyrat, arsimimi, kualifikimi.

2. Personeli i ofruesve të shërbimit të specializuar që trajton të miturit duhet të ketë arsim të lartë në fushën përaktëse që përputhet me shërbimet e ofruara duke përfshirë, por pa u kufizuar, arsimin në fushat sociale dhe mjekësore.

2. Në rastin e ofruesve jopublikë, personeli nënshkruan kontratë pune në përputhje me Kodin e Punës. Kontrata e punës përfshin:

- a) përshkrimin e detyrave;
- b) detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit;

- c) marrëdhëniet e varësisë;
- ç) referencat tek rregullorja e brendshme;
- d) kodi i etikës;
- dh) deklaratën e konfidencialitetit, si dhe
- e) çështje të tjera që lidhen me ushtrimin e detyrës.

3. Punonjësi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin, përpara fillimit të detyrës, i nënshtrohet një trajnimit të brendshëm për të kuptuar misionin e ofruesit të shërbimit dhe rolin e tij në ndihmën ndaj përfituesve të mitur.

4. Çdo ofrues shërbimesh për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ketë një program trajnimit për punonjësit e tij. Programi i trajnimit duhet të përfshijë të gjithë fushat kryesore të nevojshme të trajnimit, objektivat për secilin sesion dhe mënyrën se si do të ofrohet trajnimi.

4. Personeli i nënshtrohet trajnimit të vazhdueshëm profesional gjatë kohës së punësimit në shërbimin e specializuar për të miturit në konflikt me ligjin.

5. Detyrimet e personelit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin ndaj përfituesit afishohen në mjediset e brendshme dhe janë të aksesueshme për të miturit në konflikt me ligjin.

## Neni 5

### **Dokumentimi i personelit të shërbimit të ofruar**

Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të mbajë dosje individuale për të gjithë personelin e tij. Dosja individuale përmban dokument original ose kopje të njesuar me origjinalin të:

- a) jetëshkrimit;
- b) diplomës të arsimimit të ndjekur;
- c) vërtetimit të gjendjes gjyqësore;
- ç) certifikatës dhe/ose certifikatave profesionale;
- d) rekomandimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe/ose punëdhënësit;
- dh) përshkrimit të detyrave;
- e) librezës së punës;
- ë) kontratës së punës,
- f) vlerësimeve të performancës,
- g) vërtetimeve mjekësore;
- gj) çdo dokumenti apo vërtetimi tjetër të nevojshëm.

---

## KREU III

### **RREGULLAT PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË SPECIALIZUAR**

## Neni 6

### **Ofrimi i shërbimeve të specializuara**

1. Vendosja në shërbimin e specializuar për të miturit në konflikt me ligjin caktohet nga gjykata me vendim.

2. Çdo ofrues i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin harton një formular përmbledhës që përshkruan qartë misionin, objektivat e shërbimit, profilin që ka,

shërbimi që ofron, struktura organike për zbatimin e programeve, detyrat dhe detyrimet e stafit, procedurat e shërbimit, mbrojtja dhe siguria e përfituesit, marrëdhënia me familjarët dhe të afërmit, procedura e ankimit, deklarata e konfidencialitetit, referimi në një shërbim tjetër apo përfundimi i shërbimit të ofruar.

3. Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit duhet të përcaktojë qartë se si ofrohen shërbimet drejtpërdrejtë prej tij ose nëpërmjet referimit në institucionet ose organizatat e tjera.

4. Të miturit e vendosur në shërbimi të specializuar duhet të konfirmojnë se janë njohur me formularin përmbledhës të ofruesit të shërbimit dhe kanë marrë një kopje të tij.

5. I mituri në konflikt me ligjin, mbrojtësi dhe përfaqësuesi ligjor i tij duhet të nënshkruajnë deklaratën e pranimit, me qëllim garantimin e informimit të të miturit rreth shërbimit të specializuar që merr, si dhe mbi rregullat mbi funksionimin e shërbimit gjatë kohëzgjatjes së shërbimit të specializuar.

6. Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin rishikohet dhe përditësohet sa herë që ofruesi i shërbimit zgjeron aktivitetin e tij, me kushtin që të mos tejkalojë objektin e licensimit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

## Neni 7

### **Të drejtat dhe detyrat e të miturit në konflikt me ligjin**

1. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin hartojnë dokumentacion të qartë të të drejtave të përfituesit të shërbimit të specializuar. Këto të drejta duhet të jenë të shkruara në gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar.

2. Të drejtat duhet të përfshijnë, por pa u kufizuar, të drejtën për t'u trajtuar në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, me respekt dhe dinjitet, të drejtën për t'u dëgjuar dhe shprehur mendimet, si dhe të drejtën për t'u ankuar pa patur frikën e pasojave negative.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e të miturit që është vendosur në shërbimin e specializuar duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Ato duhet të përfshijnë të gjithë detyrimet që ka i miturit kur merr pjesë në programin e ofruesit të shërbimit të specializuar.

4. Të gjithë dokumentet e mësipërme, përfshirë të drejtat e përfituesit, detyrat dhe përgjegjësitë e përfituesit, duhet të afishohen në mjediset e shërbimit të specializuar dhe që mund të shihen dhe lexohen lehtësisht nga përfituesit dhe personeli.

## Neni 8

### **Përfshirja e të miturit në vendimmarrje**

1. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet ta përfshijnë atë në funksionimin e shërbimit dhe në vendimmarrjen që lidhet me jetën e përditshme.

2. I mituri nxitet të japë mendime për shërbimet dhe rregullat e vendosura, oraret, cilësinë e shërbimit, si dhe për elementë të tjerë që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shërbimit të ofruar.

3. Në procesin e vendimarrjes duhet të jetë prezent edhe mbrojtësi ose përfaqësuesi ligjor i të miturit, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të tij.

#### Neni 9

##### **Vlerësimi i nevojave për të miturit në konflikt me ligjin**

1. Nevojat e të miturit në konflikt me ligjin që vendoset në shërbimin e specializuar vlerësohen nga një grup multidisiplinar që ngrihet nga ofruesi, të cilët punojnë së bashku për të trajtuar rastin në përputhje me moshën dhe nevojat, me qëllim hartimin e planit individual të mbikëqyrjes.

2. Për çdo përfitues të mitur caktohet një punonjës social, i cili menaxhon rastin. Menaxheri i rastit udhëheq procesin e vlerësimit të nevojave të përfituesit, hartimin e planit të mbikëqyrjes dhe zbatimin e tij. Ai takohet rregullisht me të miturin për të diskutuar progresin e përgjithshëm në arritjen e qëllimeve individuale dhe planit të mbikëqyrjes.

3. Vlerësimi i nevojave të të miturit përfshin:

- a) vlerësimin e nevojave shëndetësore;
- b) vlerësimin e nevojave psikologjike dhe psikosociale;
- c) vlerësimin e nevojave arsimore;
- ç) vlerësimin e nevojave profesionale;
- d) vlerësimin e nevojave të punësimit;
- dh) vlerësimin e nevojave të sigurisë;
- e) vlerësimin e nevojave të lidhjeve me familjen dhe komunitetin;
- ë) vlerësimin e nevojave të tjera sipas rastit specifik.

4. Procesi i vlerësimit të nevojave individuale për përfituesin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të përfundojë brenda 3 (tre) ditëve nga kontakti i parë me të miturin, sipas udhrit të ekzekutimit të masës së sigurimit për t'u vendosur në shërbimin e specializuar.

5. Pasi kryhet vlerësimi i nevojave, grupi multidisiplinar mblidhet nga menaxheri i rastit për të hartuar planin përkatës të mbikëqyrjes së të miturit sipas vlerësimit të kryer.

#### Neni 10

##### **Programet për të miturit në konflikt me ligjin**

1. Shërbimet e specializuara ofrojnë trajtim, përkujdesje, udhëzime, këshillime, mbikëqyrje, mbështetje dhe rehabilitim për të miturin që dyshohet se ka kryer një vepër penale.

2. Bazuar në nevojat e evidentuara, programet për të miturin përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- a) ofrimin e aktiviteteve edukative, sportive, rekreative dhe kulturore;
- b) ofrimin e kujdesit psikologjik dhe psikosocial;
- c) ofrimin e përkujdesjes shëndetësore bazë dhe, kur është rasti, referimin e të miturit në institucionet përgjegjëse për kujdesin shëndetësor;
- ç) ofrimin e kujdesit shëndetësor të posaçëm në rastet e varësisë ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike e psikotrope;
- d) ofrimin e kujdesit të shëndetit mendor për të miturit që shfaqin çrregullime mendore;

dh) ofrimin e shërbimeve mbështetëse për të miturit e huaj apo pa shtetësi, si dhe të miturit që i përkasin pakicave kombëtare;

e) ofrimin e kujdesit shëndetësor të posaçëm për të miturit me aftësi të kufizuara;

ë) ofrimin e këshillimit dhe lehtësimin e ndjekjes së arsimit dhe arsimit profesional dhe punësimin;

g) ofrimin e aktiviteteve këshilluese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për respektimin e ligjit dhe të drejtave të të tjerëve.

## Neni 11

### **Plani individual i mbikëqyrjes për zbatimin e programeve**

1. Plani i mbikëqyrjes përfshin masat afatmesme dhe afatgjata të nevojave të identifikuar për përfituesin e mitur në konflikt me ligjin.

2. Plani individual i mbikëqyrjes hartohet nga menaxheri i rastit pas marrjes së informacionit të detajuar nga grupi multidisiplinar mbi nevojat e të miturit.

3. Plani i mbikëqyrjes hartohet duke përshtatur masat me nevojat e të miturit, në përputhje me programin që ofron shërbimi i specializuar.

4. I mituri në konflikt me ligjin ndaj të cilin është vendosur masa e sigurimit përfshihet në procesin e hartimit të planit të mbikëqyrjes në përputhje me moshën, zhvillimin dhe aftësitë individuale. Për hartimin e planit, kur është rasti, merret edhe mendimi i prindërve apo kujdestarit.

5. Plani i mbikëqyrjes hartohet brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendosjes së të miturit në konflikt me ligjin në shërbimin e specializuar.

6. Plani i mbikëqyrjes përditësohet e përshtatet nëse ndryshojnë nevojat dhe rrethanat në të cilat gjendjet i mituri.

7. Menaxheri i rastit dhe i mituri takohen periodikisht për të diskutuar progresin e bërë dhe për të rivlerësuar nevojat e të miturit.

8. Ofruesi i shërbimit, kur i kërkohet ose edhe kryesisht i vendos në dispozicion një kopje të planit individual të mbikëqyrjes prokurorisë dhe gjykatës që ka vendosur masën e sigurimit.

9. Në rastet kur i mituri në konflikt me ligjin nuk përmbush detyrimet e caktuara ndaj tij, punonjësi përgjegjës për mbikëqyrjen e tij njofton të miturin, prindrin ose përfaqësuesin ligjor dhe organet drejtuese të shërbimit të specializuar me qëllim marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve. Në rast se i mituri, edhe pas masave të marra nuk zbaton detyrimet e përcaktuara ndaj tij, ofruesi i shërbimit të specializuar njofton menjëherë prokurorinë dhe gjykatën që ka vendosur masën e sigurimit.

## Neni 12

### **Monitorimi i shërbimit**

1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin raporton, çdo tre muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve pranë prokurorisë dhe gjykatës që ka vendosur masën e sigurimit. Në çdo rast, ofruesi raporton sa herë që i kërkohet nga prokuroria dhe gjykata që ka vendosur masën e sigurimit.

2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike dhe jopublike të

licencuara. Ofruesi i shërbimit të specializuar monitorohet dhe inspektohet në përputhje me legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror.

3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike dhe personave juridikë jopublikë, që ofrojnë shërbimin e specializuar.

4. Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo gjashtë muaj, të dhëna mbi zbatimin e masave të sigurimit për të miturit, ndaj të cilëve është vendosura masa e sigurimit.

5. Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin gjithashtu pranë Ministrisë së Drejtësisë të dhëna periodike mujore mbi të miturit ndaj të cilëve është vendosura masa e sigurimit, llojin e veprës penale për të cilën është vendosur masa e sigurimit dhe kohëzgjatjen e saj.

### Neni 13

#### **Mbikëqyrja pas përfundimit të shërbimit të specializuar**

Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin, kur është rasti, vlerësojnë mundësinë për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin edhe pas përfundimit të masës së sigurimit, nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit.

### Neni 14

#### **Vlerësimi i shërbimit të ofruar**

1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin i kërkon të miturit, mbrojtësit dhe përfaqësuesit ligjor të plotësojnë në mënyrë anonime formularin e vlerësimit të shërbimit.

2. Nëpërmjet formularit vlerësohen shërbimet e ofruara, në mënyrë që shërbimet të përmirësohen sipas nevojave.

3. Formulari plotësohet çdo tre muaj ose dhe më shpesh, në rastet kur janë ndërmarrë veprime për të trajtuar ankesat, opinionet dhe sugjerimet ndaj shërbimeve të ofruara.

4. Në momentin e përfundimit të shërbimit të specializuar, i mituri plotëson formularin e vlerësimit përfundimtar.

### Neni 15

#### **Ankimi mbi cilësinë e shërbimit të specializuar**

1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin zbaton procedura të qarta dhe të thjeshta për trajtimin e ankesave. Këto procedura, të cilat janë pjesë e standardeve të shërbimit janë të hapura për të gjithë të miturit ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit, mbrojtësit dhe/ose përfaqësuesit ligjor dhe familjarët e tyre.

2. Ankesat mund të jenë me shkrim ose në formë verbale.

3. I mituri, mbrojtësi ose përfaqësuesi i tij ligjor mund të ankohen në organet drejtuese të ofruesit të shërbimit ose strukturat monitoruese dhe inspektuese rreth çdo aspekti të cilësisë së ofrimit të shërbimit të specializuar duke respektuar procedurat e ankimit.

4. Rregullorja e brendshme e ofruesit të shërbimit përfshin procedurën e ankimit që përmban kushtet e konfidencialitetit, afatet e përgjigjes, organet dhe personat që trajtojnë

ankesën. Të gjitha ankesat e marra me gojë apo shkrim dhe përgjigjet e dhëna hidhen në regjistrin e ankesave, dhe i gjithë dokumentacioni mbahet në një dosje të veçantë

5. Personeli i ofruesit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin që merr një ankesë verbale, mban procesverbal të veçantë mbi përmbajtjen e ankesës dhe e regjistron atë në regjistrin e ankesave, së bashku me datën e ankesës, si dhe dokumenton mënyrën e trajtimit të saj.

6. Të gjitha ankesat duhet të marrin përgjigje me shkrim brenda 7 (shtatë) ditëve dhe një kopje e përgjigjes me shkrim përfshihet në regjistrin e ankesave.

7. Ankimet që lidhen me të drejtat procedurale të të miturit, bëhen pranë prokurorisë ose gjykatës që ka dhënë masën e sigurimit nga mbrojtësi ose përfaqësuesi ligjor i të miturit.

#### Neni 16

### **Bashkëpunimi me struktura dhe shërbime të tjera të specializuara për të miturit**

1. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturin në konflikt me ligjin bashkëpunojnë me strukturat dhe shërbimet e tjera, duke siguruar ndjekjen dhe ecurinë e plotësimin e nevojave dhe rikthimin e tij në shoqëri.

2. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera, me qëllim ofrimin e shërbimeve të posaçme, si klinika mjekësore apo spitale, insitucione arsimore dhe institucione të tjera sipas shërbimit të ofruar, për të realizuar një ose disa shërbime të caktuara.

#### Neni 17

### **Ndërprerja e ofrimit të shërbimit**

Në rastet kur ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin nuk është më i aftë të vijojë veprimtarinë, drejtuesi njofton menjëherë prokurorinë dhe gjykatën që ka vendosur masën e sigurimit, si dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale me qëllim përditësimin e listës së ofruesve të shërbimeve të specializuara.

## **KREU IV**

### **ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE PERSONALE TË TË MITURIT PËRFITUES**

#### Neni 18

### **Administrimi i të dhënave**

1. Për çdo të mitur në konflikt me ligjin që qëndron në shërbimin e specializuar, ofruesi krijon dhe administron një dosje individuale.

2. Dokumentacioni mbahet në vend të sigurte. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të sigurojë që dosjet e printuara dhe dosjet elektronike me të dhëna të ruhen të sigurta. Dosjet e printuara, ruhen në raftet të mbyllura me çelës në një dhomë që është e kyçur ndërsa dosjet elektronike ruhen me fjalëkalim.

3. Dokumentacioni mund të aksesohet vetëm nga prokurori, gjyqtari, menaxheri i rastit, dhe drejtuesi i ofruesit të shërbimit, vetëm për qëllime në interes të të miturit, si dhe nga mbrojtësi dhe përfaqësuesi ligjor i të miturit.



4. Ofruesi i shërbimit të specializuar të të miturit në konflikt me ligjin vendosë kufizime të personave që mund të vizitojnë mjediset e shërbimit, veprimet e lejuara për vizitorët dhe frekuenca e vizitorëve. Rregullat për vizitat duhet të jenë të shkruara dhe të jenë afishohen në vende të dukshme.

#### Neni 19

### **Përpunimi i të dhënave dhe ruajtja e konfidencialitetit**

1. Administrimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat e dokumentacionit të të miturit në konflikt me ligjin janë konfidenciale.

2. Personeli i shërbimit të specializuar për të miturit që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

## **KREU V**

### **RREGULLAT PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA**

#### Neni 20

### **Financimi i programve**

1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ketë burime të mjaftueshme për të realizuar programet e planifikuara në mënyrë cilësore.

2. Ofruesit e shërbimeve të specializuara, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

3. Programet që ofrohen nga personat juridik publikë që ofrojnë shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin financohen, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror nga;

- a) fondet e deleguara nga buxheti i shtetit, përfshirë fondin social;
- b) fondet nga buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore;
- c) të ardhura të tjera të ligjshme.

4. Programet që ofrohen nga personat juridik privatë të licencuar që ofrojnë shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin mund të financohen sipas shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, vetëm nëse kanë lidhur kontratë për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

## **KREU VI**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### Neni 21

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, të miratojnë udhëzimin sipas nenit 2, pika 7, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Neni 22  
**Institucionet e ngarkuara**

Ngarkohen insitucionet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, subjektet e licencuara për ofrimin e shërbimeve të specializuara, ministria përgjegjësie për çështjet sociale dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 23  
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet finaniare nga data 1 janar 2024.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**